



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr. 1711 Prot.

Tiranë, më 24.03. 2016

URDHËR

Nr. 117 datë 24.3.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR. 28, DATË 26.01.2016, "PËR SISTEMIN E REFERIMIT DHE TARIFAT E SHËRBIMIT SHËNDETËSOR PUBLIK"

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Ligjin nr. 10107, datë 30.03.2009, "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe në Ligjin nr. 10383, datë 24.02.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në tabelën A me titull "Vizita ambulatorë", të Aneksit 1 "Tarifat për shërbimet mjekësore për pacientët në kujdesin shëndetësor parësor, ambulator dhe spitalor, sektori publik" bashkëlidhur Urdhrit nr. 28, datë 26.01.2016, "Për sistemin e referimit dhe tarifave të shërbimit shëndetësor publik", në kolonën B dhe C, shtohen dy tarifa të reja, si vijon:
"8. Vizitë te mjeku specialist në poliklinikë me qëllim lëshimin e lejes së drejtimit për mjetet motorike, 1500 lekë";
"9. Vizitë te mjeku specialist në poliklinikë me qëllim lëshimin e raportit mjekësor për veprimtaritë me armët, 1500 lekë".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

